



Pranuar / Dorezuar Puniljenol/Prudato Received/Delivery	10.05.2023	viti god year	3
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHOK	4163/2023		1/5



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.487/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.487/2023 të datës 13.03.2023 e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ të cilin me autorizim e përfaqëson \_\_\_\_\_ me adresë banimi \_\_\_\_\_

kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike "Ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 10.05.2023, mori këtë:

### V E N D I M

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës Shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.487/2023 të datës 13.03.2023 e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_

II. Çështja bije në kompetencë të Gjykatës Kompetente.

### A r s y e t i m

Ankuesi \_\_\_\_\_ përmes përfaqësuesit me autorizim, me datë 13.03.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2571/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.ref.197/2023 të datës 06.03.2023 të Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (tutje MPJD), për shkak të shkeljeve të dispozitave materiale dhe procedurave ligjore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 28.03.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Ndërsa Këshilli me datën 07.04.2023 ka pranuar shkresat lidhur me çështjen ankimore në vendosje.



Me datën 25.04.2023, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin VK/2023 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokolli 2571/2023 të datës 13.03.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës se bashku me shkresat e bashkangjitura si Komunikimin elektronik të datës 10.03.2023; Formularin për vlerësim të rezultateve në punë të ankuesit të datës 31.01.2023, Formularin e vlerësimit për nëpunësit e shërbimit të jashtëm për ankuesin të vitit 2019 të datës 19.11.2019, Formularin e vlerësimit për nëpunësit e shërbimit të jashtëm për ankuesin të vitit 2018 të datës 26.10.2018, Formularin e vlerësimit për nëpunësit e shërbimit të jashtëm për ankuesin të vitit 2017 të datës 22.11.2017; Vendimin Nr.Ref.137/2023 të datës të zv.Ministres së Jashtme në MPJD; Akt emërimit e ankuesit Nr.92/2022 të datës 13.06.2022; Vendimin Nr.117/2022 të datës 12.05.2022; Kopjen e ID-së së ankuesit; Akt emërimit e ankuesit Nr.12/2021 të datës 19.02.2021; Vendimin Nr.131/2020 të datës 01.09.2020; Vendimin Nr.328/2020 të datës 10.07.2020; Vendimin Nr.289/2020 të datës 30.06.2020; Vendimin Nr.198/2020 të datës 13.05.2020; Vendimin Nr.Ref.99/2020 të datës 27.03.2020; Vendimin Nr.Ref.850/2018 të datës 16.10.2018; Kërkesën e ankuesit të datës 17.09.2018 me numër D/127; Komunikimin elektronik të datës 17.10.2018; Vendimin Nr.586/2018 të datës 13.07.2018; Komunikimin elektronik të datës 17.03.2022, 29.04.2014; Vendimin e datës 24.04.2014; Shkresën zyrtare të datës 16.08.2011; Komunikimin elektronik të datës 17.03.2022, 04.06.2022, 27.01.2022, 06.01.2022, 06.02.2012; Akt emërimit e ankuesit Nr.Prot.212/2011 të datës 24.10.2011; Kontratën e marrëdhënies së punës Ref.207/08 të datës 24.11.2008; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Autorizimin e datës 10.03.2023 të përfaqësuesit të ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 08.03.2023 nga KPMSHCK; Përgjigjen në ankesë të datës 07.04.2023 së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Vendimin Nr.140/11 të datës 21.07.2011; Konkursin e datës 22.07.2011; Listën e kandidatëve aplikues-gusht 2011; Vendimin A.nr.365/2022 të datës 10.06.2022 nga KPMSHCK; Vendimin Nr.ref.246/2014 të datës 25.04.2014; Vendimin Nr.Ref.197/2023 të datës 06.03.2023; Akt emërimit e ankuesit Nr.92/2022 të datës 13.06.2022; Vendimin Nr.Ref.850/2018 të datës 16.10.201 si dhe Vendimin VK/2023 të datës 25.04.2023 lidhur me vazhdimin e afatit të ankesës së ankuesit në Këshill.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas administrimit të shkresave të lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil **nuk është kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.487/2023 të datës 13.03.2023 të parashtruar nga ankuesi

*sepse:*

Nga analizimi i provave materiale Kolegji ka gjetur se Ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme me Vendimin Nr.140/11 të datës 21.07.2011 ka miratuar shpalljen e Konkursit për përfaqësues diplomatik dhe konsullor në misionet diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës. Bazuar në këtë vendim, Ministria e Punëve të Jashtme më datë 22.07.2011 ka shpall konkursin për drejtues dhe nëpunës të tjerë të misionit konsullor dhe për anëtarë të misionit diplomatik, e në të cilin konkurs kishte aplikuar edhe ankuesi. Më tej, nga shkresat e lëndës rezulton se lidhur me këtë procedurë konkurrimi ishte organizuar vetëm testimi i gjuhëve të huaja dhe intervista me gojë, dhe nga kjo fazë nuk ka dëshmi për vazhdimin e mëtejshëm të procesit të rekrutimit në fjalë, gjegjësisht pranimit të ankuesit në pajtim me dispozitat e aplikueshme për shërbimin e jashtëm dhe shërbimin civil.



Rrjedhimisht nga shqyrtimi i provave materiale Kolegji ka konstatuar se ankuesi fillimisht sipas Kontratës së marrëdhënies së punës Ref:207/08 të datës 24.11.2008 ka mbajtur pozitën si Zyrtar i lartë për hulumtim në Divizionin për raportim dhe monitorim në Zyrën e Kryeministrit-Agjencia për Barazi Gjinore. Bazuar në Vendimin Nr.Ref.246/12 të datës 25.04.2014 të Ministrit të Punëve të Jashtme emërohet anëtar i shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës duke i'u caktuar grada diplomatike "Konsull", dhe njëkohësisht i njëjti caktohet të shërbej si Konsull në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Lubjanë/Republika e Sllovenisë duke filluar nga data 01.05.2014. Tutje, bazuar në provat e lëndës rezultoi se ankuesi me Vendimin Nr.586/2018 të datës 13.07.2018 të Ministrit të MPJ-së i është vazhduar mandati në këtë mision deri me datën 30.04.2022, kurse sipas Vendimit Nr.Ref.850/2018 të datës 16.10.2018 të Ministrit të MPJ-së i është dhënë grada diplomatike Sekretar i Parë. Ndërsa sipas Vendimit Nr.Ref.99/2020 të datës 27.03.2020 të Ministrit të MPJ-së është kthyer nga misioni diplomatik ku kthimi tij është caktuar të bëhet me datën 30.06.2020. Ministri i MPJ-së me datën 13.05.2020 sipas Vendimit Nr.198/2020 ka shtyre ekzekutimin e vendimeve që i referohen tërheqjes së diplomatëve nga misionet diplomatike apo konsullore e po ashtu edhe sipas Vendimit nr.259/2020 të datës 30.06.2020 të Ministres së MPJ-së është bërë shtyrja e ekzekutimit-pezullimit lidhur me vendimet e pezulluara me qëllim që të vlerësohet ligjshmëria e vendimeve të pezulluara. Sipas Vendimit Nr.328/2020 të datës 10.07.2020 të Ministres së MPJ-së thuhet se ankuesi tërhiqet /kthehet nga misioni diplomatik pas përfundimit të mandatit me datën 30.08.2020, duke u sistemuar në pozitën Zyrtar i Lartë për Marrëdhënie Dypalëshe sipas Vendimit Nr.131/2020 të datës 01.09.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të MPJ-së, kurse i njëjti sipas Akt emërimit me numër AE.Nr.12/2021 të datës 19.02.2021 i njëjti ka mbajtur pozitën si Zyrtar i lartë për marrëdhënie dypalëshe. Bazuar në Vendimin Nr.117/2022 të datës 12.05.2022 të zv.Drejtoreshes së DMZP-së i njëjti është transferuar në pozitën Zyrtar i lartë për marrëdhënie shumëpalëshe për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit ku edhe i është lëshuar Akt emërimi me numër .Nr.92/2022 me datën 13.06.2022 nga Udhëheqësi i Divizionit të Burimeve Njerëzore në MPJD.

Ministrja e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës me Vendimin Nr.ref: 197/2023 të datës 06.03.2032 ka shfuqizuar Vendimin me numër reference 246/14 të datës 25.04.2014 lidhur me emërimin e ankuesit në shërbim të jashtëm si dhe Vendimin me Nr.Ref.328/2020 të datës 10.07.2020 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, mbi bazën ligjore se emërimi i ankuesit në shërbim të jashtëm është bërë në kundërshtim me nenin 20 të Ligjit Nr.03/L-022 për Shërbimin e Jashtëm, si dhe në kundërshtim me nenin 19 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendon se vendimi i kundërshtuar më ankesë karakterizohet me shkelje të dispozitave ligjore, shkelje formale-procedurale, dhe shkelje të ligjit material, konkretisht Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr.03/L-022 për Shërbimin e Jashtëm dhe Ligjit Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në kuptim të pranueshmërisë së ankesës, Kolegji ju referua dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës i aplikueshëm në kohën e emërimit të ankueses në shërbim të jashtëm, përkatësisht nenit 3 paragrafi 4 ku përcaktohet se: *4. Personeli diplomatik dhe konsullor, si dhe personeli administrativ i dërguar jashtë vendit ose i punësuar në Ministrinë e Punëve të*



Jashtme të Kosovës, është pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe i nënshtrohet këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi, si dhe nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik me të cilin parashihet: Anëtarët e Shërbimit Diplomatik të Kosovës, përveç të emëruarave politik, janë pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe personeli i tij i nënshtrohet të njëjtave paga, kërkesa dhe kushte të punës, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj ose me ligje tjera ose akte nënligjor, dhe rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore Kolegji konstaton se përveç të emëruarave politikë, nëpunësit e shërbimit të jashtëm përfshirë personelin diplomatik, konsullor dhe personelin administrativ të punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme apo të angazhuar në shërbim të jashtëm, kanë statusin e nëpunësit civilë dhe se pranimi i tyre në shërbim të jashtëm duhet të bëhet në pajtim me dispozitat e legjislacionit për shërbim të jashtëm dhe legjislacionit të aplikueshëm për shërbim civil, andaj mbi këtë bazë ligjore, si dhe duke marrë parasysh faktin se ankuesi ishte emëruar në shërbim të jashtëm mbi bazën e vendimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, e meqenëse me asnjë provë nuk vërtetohet se i njëjti ka themeluar marrëdhënie të punës në shërbim civil pranë këtij institucioni përmes nënshkrimit të Aktit të emërimit ashtu siç përcaktohej me nenin 19 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës me të cilin parashihej se: Nëpunësit civilë themelojnë marrëdhënien e punës pas përfundimit me sukses të procedurave të pranimit të përcaktuara me këtë ligj dhe me aktet përkatëse nënligjore dhe pas pranimit të një shkrese të emërimit brenda tridhjetë (30) ditëve pas përfundimit të procedurës nga institucioni kompetent në të cilën do të gjejë punë nëpunësi i ri civil...., Kolegji duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragraf 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit si në dispozitiv të këtij vendimi.

Bazuar në rrethanat si me lartë, Kolegji i Këshillit pas analizimit të provave të lëndës me qenë se konstatoi se nuk është kompetent të vendosë në lidhje me këtë ankesë, nga se kompetente është gjykata përkatëse, duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda, A.nr.487/2023, datë 10/05/2023.

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit me autorizim,
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punës së Jashtme dhe të Diasporës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punës së Jashtme dhe të Diasporës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së